

Të dhëna bazike të lëndës - SYLLABUSI			
Njësia akademike:	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike		
Departamenti	Inxhinieria industriale dhe menaxhmenti		
Titulli i lëndës:	Projektimi i proceseve teknologjike		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Semestri	V		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6,0		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc.dr. Nexhat Qehaja		
Përshkrimi i lëndës	Njohuri bazike mbi projektimin e proceseve teknologjike, teknologjive përpunuese, instrumenteve, pajisjeve ndihmese dhe makinave, studimi dhe racionalizimi i punës, analiza e kohëve të punës dhe shpenzimeve të përpunimit, projektimi i proceseve teknologjike grupore.		
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me qëllimet dhe funksionin përgatitjes së prodhimit. Nocioni dhe rëndësia e projektimit të proceseve teknologjike (PPT). PPT me shembuj (zgjedhja e procesit primar, zgjedhja e renditjes së operacioneve, instrumenteve, makinave). Përcaktimi i normës së kohës dhe materialit, llogaritja e kohës së punimit, llogaritja e shpenzimeve të punimit. Optimalizimi i PPT-ve me shembuj. Qasja ndaj modernizimit të prodhimit. Avancimi dhe zhvillimi i PPT-ve.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<i>Studentët do të kenë njohuri</i> : të pavarura mbi projektimin e proceseve teknologjike, renditjen e operacioneve të përpunimit, instrumenteve, pajisjeve dhe makinave. Llogaritjen e normës teknike të kohës së punës dhe shpenzimeve të përpunimit.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	8	16
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	0	0	0

Total			146
Metodologjia e mësimëdhënies:	Ligjërata të prezantuara në mënyrë elektronike, punime seminarike përmes shembujve konkret në praktikë dhe punës praktike gjatë vizitave në fabrika.		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	<i>Pjesa teorike (%)</i>	Pjesa praktike (%)	
	60%	40%	
Literatura bazë:	[1] Qehaja, N.: Projektimi i proceseve teknologjike, FIM,2019. [2]. Ćosić, P. : Osnove projektiranja tehnoloških procesa, WEB priručnik, FSB, Zagreb, 2003 (u pripremi). [3]. Halevi, G. ; Weill, R.D.: Principles of Process Planning, Chapman & Hall, London, 1995. [4]. Taboršak, D.:Studij rada, Orgdata, Zagreb, 1994.		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
<i>Java e parë:</i>	Hyrje. Rëndësia e projektimit të proceseve teknologjike (PPT). Pozita e përgatitjes në ndërmarrje.		
<i>Java e dytë:</i>	Bazat e teknologjisë së përpunimit, shfrytëzimit të makinave, instrumenteve dhe pajisjeve ndihmëse.		
<i>Java e tretë:</i>	Rëndësia e qasjes sistemore të PPT, zgjedhja e procesit primar.		
<i>Java e katërt:</i>	Bazat e projektimit të proceseve teknologjike klasike, nocionet e operacionit, fazes, kalimit si dhe formimit të dokumentacionit teknologjik.		
<i>Java e pestë:</i>	Zgjedhja e opracioneve, renditjes së operaconeve, makines, instrumentit, variantit të procesit teknologjik.		
<i>Java e gjashtë:</i>	Dimensionimi dhe tolencat e produktit, pozicionimi dhe shtrëngimi, gabimet e përpunimit.		
<i>Java e shtatë:</i>	Funksioni, forma dhe gjeometria e të gjitha llojeve të instrumenteve (standarde dhe speciale).		
<i>Java e tetë:</i>	Kuptimi dhe llojet e pajisjeve, kakarakteristikat themelore, klasifikimi, shembuj të aplikimit.		
<i>Java e nëntë:</i>	Studimi i punës. Racionalizimi i punës. Projektimi/formësimi i punës.		
<i>Java e dhjetë:</i>	Stuktura e kohës së punës. Përcaktimi, matja si dhe projektimi i kohës.		
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Projektimi i proceseve teknologjike grupore. Punimi i PPT Për makinat CNC dhe qendrat përpunuese.		
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Projektimi i proceseve teknologjike me kompjuter CAPP.		
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Modelimi dhe optimalizimi i proceseve teknologjike. Llogaritja e shpenzimeve të prodhimit..		

Java e katërmbëdhjetë:	Strategjitë e prodhimit dhe metodat e përmirësimit të procesit prodhues(Kaizen, Lean, Reengineering, SE-Simultaneous engineering, CE-Concurrent Engineering,...).
Java e pesëmbëdhjetë:	Metodat e avansimit e teknologjik të prodhimit, transferi teknologjik, kriteret e suksesit. Interakcioni (ndërveprimi) i programit të prodhimit, pajisjeve prodhuese me strategjinë e zgjedhur prodhuese.
Mënyra e dhënies së provimit:	Testimi gjatë vitit, seminarët, dhe provimi përfundimtar
Literatura shtesë:	[1]. TECHNICAL PROJECT PLANNING (TPP) PROCESS, Engineer Manual 200-1-2 [2]. Samoa, Design and technology, “The design process”